

VENDIM
Nr. 612, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË VENDIMIN NR. 285, DATË 10.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, SI DHE PROCEDURAT E NIVELIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË DO TË OFROHEN NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE (ATRAKO)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, “Organizimi dhe funksionimi i ATRAKO-s”, të vendimit nr. 285, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ATRAKO-s rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”.

b) Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1, 8/2 dhe 8/3, me këtë përmbajtje:

“8/1. Kryetari i ATRAKO-s emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Kryetari i ATRAKO-s duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë” ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkencat ekonomike/juridike;
- ç) të ketë përvojë në profesion, të paktën 3 (tre) vjet;
- d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;
- dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

8/2. Kryetari i ATRAKO-s lirohet nga detyra, kur:

- a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;
- b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
- c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- ç) jep dorëheqjen nga detyra.

8/3. Kryetari i ATRAKO-s shkarkohet nga detyra, kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;
- b) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin specifik mbi të cilën ushtron veprimtarinë e ATRAKO-s;
- c) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;

ç) konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike, sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

d) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

dh) vërtetohet se ka përgjegjësi për mosrealizimin e objektivave të vendosur për ATRAKO-n.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku